



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 13131 prot.

Tiranë më 26.11.2021

Lënda: Mendim për projektvendimin për “Miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik të Organizatave Jofitimprurëse, për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara”

MINISTRISË Ë DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj, nr. 5977 prot., datë 17.11.2021, me anë së cilës dërgoni për mendim për “*Miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik të Organizatave Jofitimprurëse, për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara*” dhe relacionin shpjegues, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim Zyra e Komisionerit).

Nga shqyrtimi i relacionit dhe i projektvendimit, konstatohet se krijimi i Regjistrin Elektronik i Organizatave Jofitimprurëse bazohet në ligjin nr. 80/2021 “*Për regjistrimin e organizatave Jofitimprurëse*” dhe ligjin nr. 10 325, datë 23.09.2010 “*Për bazat e të dhënave shtetërore*”. Gjithashtu, krijimi i kësaj baze të dhënash nuk synon përafrimin e me legjislacionin komunitar.

Nga përmbajtja e pikës 9 të projektvendimit, vërejmë se të dhënat ndahen në dy kategori, në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore.

Sa më lart, në projektvendim nuk është evidentuar se cilat të dhëna do të jenë publike në Regjistrin Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse dhe cilat jo. Për këtë arsye nga ana juaj duhet të parashikohet një pikë e cila rregullon parashikimet e nenit 7 dhe 38 të ligjit nr. 80/2021 “*Për regjistrimin e organizatave Jofitimprurëse*”, në çdo rast duke garantuar kriteret dhe parimet për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor kanë detyrimin të marrin masa tekniko-organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale dhe ruajtjes së konfidencialitetit, në përputhje me nenet 27 dhe 28 të Ligjit nr.9887/2008.

Në këtë kontekst, detyrimet që burojnë nga dispozitat e mësipërme ligjore, zërthehen, më konkretisht, në aktet nënligjore të Komisionerit të nxjerra në zbatim të dispozitave në fjalë, ku veçojmë, ndër të tjera, parashikimet detyruese të udhëzimit nr.47, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”*.

Nga sa parashtrohet më sipër, sugjerojmë që pas pikës 13,të projektvendimit të shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

“13/1 Regjistrit Elektronik i Organizatave Jofitimprurëse administrohet dhe mirëmbahet, në përputhje me parimet, kriteret, si dhe masat tekniko-organizative të zbatueshme për garantimin dhe menaxhimin e sigurisë në përpunimin e të dhënave personale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

